

Takim Informues nga ASCAL – Sondazhi Kombëtar i Studentëve 2022

Takim informues me grupin e punës dhe studentët e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, data 14 Prill 2022 ora 10.00 - 11.00, në Korpusin kryesor, salla 107.

SKS është një proces i cili ka në qendër studentin dhe ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e Institucioneve të Arsimit të Lartë në veprimtaritë e mësimdhënies, mësimnxënies, kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve. Të dhënat e nxjerra nga ky Sondazh do të shërbejnë për marrjen e vendimeve të rëndësishme në hartimin e politikave shtetërore në fushën e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në Arsimin e Lartë.

Pyetësi do të jetë i aksesueshëm nga studentët duke filluar nga data 25 Prill deri më 25 Maj.

